



DOSJA E TENDERIT

Sipas Nenit 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

“PROCEDURA E KUOTIMIT TË ÇMIMIT” Shërbim

Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit: 30/05/2022

Numri i prokurimit: 02/2022-ODK

Titulli: Përditësimi i të dhënave për dy platforma digjitale dhe ofrimi i dy zgjidhjeve të reja digjitale sipas projekteve që implementohen nga Open Data Kosovo (ODK)

KJO DOSJE E TENDERIT PERBEHET PREJ TRI PJESËVE:

Pjesa A:	Informacione për Tenderuesit;
Pjesa B:	Draft Kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t'i pranojë tenderuesi që merr kontratën;
Pjesa C:	Formulari i Kuotimit.

Kjo dosje e tenderit është përgatitur në gjuhën Shqipe.

LËNDA

Ftesë për kuotim të çmimit për: Përditësimi i të dhënave për dy platforma digjitale dhe ofrimi i dy zgjidhjeve të reja digjitale sipas projekteve që implementohen nga Open Data Kosovo (ODK)

Prishtinë : 02.06.2022

Ju faleminderit për interesimin e juaj për pjesëmarrje në aktivitetin e lartë përmendur të prokurimit.

Sipas kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentet, të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit

Nga ju pritet që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët dhe seksionet e kësaj dosje të tenderit dhe anekset e saj dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Open Data Kosovo nuk pranon asnjë ndryshim.

Në rast të dështimit të dorëzimit të tenderin tek autoriteti kontraktues brenda afatit të caktuar në Dosjen e Tenderit, dhe/apo nuk është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, tenderi i juaj do të refuzohet dhe do të konsiderohet si *"tender i papërgjegjshëm"*.

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin e tenderit duhet të barten nga tenderuesi, ndërsa autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura.

Kjo procedure e tenderimit është e rregulluar me Ligjin e Prokurimit Publik (Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092) dhe rregullave të prokurimit të nxjerra në përputhshmëri me të.

LPP-ja dhe Rregullat e Prokurimit mund të shkarkohen nga web-faqja e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP): www.krpp.rks-gov.net.

Kuotimi i çmimit duhet të dorëzohet në adresën e specifikuar në pjesën A "Procedurat e Tenderimit" më **15.06.2022 ora 12:00**.

Me dorëzimin e tenderit, tenderuesi pranon në mënyrë të plotë dhe pa rezerva kushtet që rregullojnë këtë kontratë të propozuar si një bazë të vetme të kësaj procedure të tenderimit.

Mirëpresim pranimin e Kuotimit tuaj.

Nëse vendosni të mos e dorëzoni çmimin e kuotimit, do të ishim mirënjohës nëse do të na lajmëronit me shkrim, duke cekur arsyet e vendimit të juaj.

DOSJA E TENDERIT PËR Procedurën e Kuotimit të Çmimit

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA A: INFORMACIONE PËR TENDERUESIT	4
NENI I IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES	4
NENI II QËLLIMI I KONTRATËS	4
NENI III KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET EKONOMIK	6
NENI IV INFORMACIONE SHITESË	7
NENI V ANKESAT	8
PJESA B: Draft KONTRATA	15
PJESA C: FORMULARI I PARAQITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT	16
Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT	16
Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT	18

PJESA A: INFORMACIONE PËR TENDERUESIT

Në tërë këtë dosje të tenderit ju referoheni si "Operatori Ekonomik" ose "Tenderuesi".

Lëshuesi i kësaj dosjeje të tenderit është referuar si "Autoriteti Kontraktues".

Ju duhet të kuotoni **të gjithë artikujt** e specifikuar në këtë Dosje të Tenderit. Ju duhet të ofroni një çmim fiks **të shumës së plotë në Euro**, duke përfshirë të gjitha taksat dhe detyrimet e zbatueshme si dhe çdo pagesë tjetër apo të taksë të transportit, sigurimit, instalimit, detyrime apo taksa të tjera.

Kuotimi i çmimeve do të vlerësohet për të gjithë artikujt së bashku dhe kontrata do t'i ipet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin më të mirë në përputhje me kriteret për dhënien e kontratës të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

NENI I IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

I.1 EMRI ZYRTAR DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK:	Open Data Kosovo		
Adresa e AK:	Rr. Ganimete Tërbeshi, 26A, Aktash, 10000 Pristina, Republika e Kosovës.		
Adresa elektronike:	https://opendatakosovo.org/	Kodi postar i qytetit të AK:	10 000
Personi kontaktues:	Ariana Gjuli	E-mail:	info@opendatakosovo.org
Telefoni:	+383 (0)49 962 656	Faksi:	n/a

(Kuotimi i çmimit duhet të dorëzohet në adresën e autoritetit kontraktues si më lart.)

NENI II QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës: Përditësimi i të dhënave për dy platformave digjitale dhe ofrimi i dy zgjidhjeve të reja digjitale sipas projekteve që implementohen nga Open Data Kosovo (ODK)

II.2 Qëllimi i kësaj kontrate është kryerja e shërbimeve, nga operatori ekonomik si në vijim:

DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e Kuotimit të Çmimit

Open Data Kosovo (ODK) është duke implementuar një numër të projekteve gjatë periudhës: Qershor 2022 – dhjetor 2023. Këto projekte mbështeten nga donatorë të ODK. Projektet referuese në lidhje me këtë kontratë janë:

1. Hulumtimi dhe Përditësimi i portalit të Bizneseve të Hapura (biznesetehapura.com)
2. Zhvillimi i mëturjeshëm i portalit Edu-performanca, shitmi i të dhënave dhe moduleve (edu-performanca.org)
3. Zhvillimi i zgjidhjeve digjitale, për digjitalizim të proceseve në dy institucione të përzgjedhura publike

Vlera maksimale e parashikuar për realizimin e këtyre projekteve =23,000.00EUR.

II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike – realizimi i projekteve duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me specifikimet teknike të parashtruara në dosje të tenderit, Aneksi 1.

II.5 Vendi i dorëzimit të shërbimeve bëhet përmes postës elektronike: info@opendatakosovo.org.

II.6 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: më së largu **10 ditë kalendarike, pas nënshkrimit të kontratës**. Afati i dorëzimit të furnizimeve duhet të jetë jo më shumë se **10 ditë kalendarike**, nga marrja e *Fletë porosisë* nga Menaxheri i Kontratës.

NENI III KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET EKONOMIK

Operatorët ekonomik duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat në vijim. Çdo mos përmbushje e ndonjëres nga kërkesat do të eliminojë tenderin e tyre nga konkurrimi.

KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË

- a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65.
- b. **Një dokument nga Administrata Tatimore** e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit *para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë*.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- a. **Një deklaratë e shkruar nën Betim**, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit, **Aneksi 2** (Origjinal).
- b. **Vërtetimin nga Administrata Tatimore** (kopje). *Duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues*, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të këtij vërtetimi, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e Kuotimit të Çmimit

III.2 KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË PROFESIONALE

Kërkesa:

- a. **Certifikatë e regjistrimit të biznesit**, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë.

Dëshmia:

- a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (**kopje**).

III.3 KËRKESAT MBI GJENDJEN EKONOMIKE DHE FINANCIARE

N/A

III.4 KËRKESAT MBI MUNDËSITË TEKNIKE DHE/OSE PROFESIONALE

Kërkesat:

- a. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë së paku dy CV të ekspertëve të dëshmuar, që kanë njohuri të të dhënave dhe gjuhë programuese: Të paktën një person me fakultet të mbaruar të shkencave kompjuterike dhe/ose një konsulent softuerik me njohura të dëshmuar në JavaScript, Java, HTML, CSS, React, Angular.

Dëshmi:

- a. CV të nënshkuara nën betim me referenca përkatëse.

NENI IV INFORMACIONE SHITESË

IV.1 AFATI KOHOR PËR KËRKESAT E INFORMACIONEVE SHITESË OSE SQARUESE

Operatorëve ekonomik u lejohe të bëjnë **kërkesë me shkrim përmes postës elektronike**, për të kërkuar nga autoriteti kontraktues informata sqaruese ose shitesë që mendojnë se janë të nevojshme për përgatitjen dhe për dorëzimin e Kuotimit të Çmimit të përgjegjshëm. Një kërkesë e tillë duhet të pranohet nga autoriteti kontraktues, jo më vonë se: **06.06.2022 ora 14:00**

Një kërkesë e tillë mund të bëhet me anë të përdorimit të formularit të kërkesës, Aneksi 3, dhe t'i dorëzohet autoritetit kontraktues në mënyrë elektronike, me shkrim ose me faks. Çdo sqarim i dosjes së tenderit do të komunikohet njëkohësisht me shkrim të gjithë ofertuesve.

IV.2 AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E KUOTIMEVE TË ÇMIMIT

Kuotimet e çmimeve do të pranohen nga autoriteti kontraktues më së voni me:

Data:	15.06.2022	Koha:	14:00	Vendi:	Tenderi duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike:
					<u>info@opendatakosovo.org</u>

Operatorët ekonomik mund t'i dorëzojnë vetëm një kuotim të çmimit dhe nuk mund të bëjnë asnjë ndryshim në kuotimin e çmimeve të dorëzuara.

DOSJA E TENDERIT PËR Procedurën e Kuotimit të Çmimit

IV.3 HAPJA E KUOTIMEVE:

Autoriteti Kontraktues do të bëjë hapjen e kuotimeve në publik me:

Data:	17.06.2022	Koha:	14:30	Vendi:	Rr. "Ganimete Tërbeshi", 26A, Aktash, 10000 Pristina, Republika e Kosovës.
--------------	-------------------	--------------	--------------	---------------	--

IV.4 FORMULARI I KUOTIMIT TË ÇMIMIT dhe LISTA E DOKUMENTEVE TË KËRKUARA

Kuotimi i Çmimit do të përmbaj si në vijim:

- Formularin e kuotimit të çmimit;**
- Formulari i përshkrimit të çmimit;**
- Deklaratën nën Betim te nënshkruar, Aneksi 2 dhe**
- Çdo dokument tjetër të kërkuar sipas nenit III.2, III.3 dhe III.4 të kësaj Dosjeje të Tenderit.**

IV.5 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Kuotimi i çmimeve do të jetë i vlefshëm për **30 ditë** nga afati i dorëzimit të kuotimeve të çmimit.

Operatori ekonomik nuk mund ta tërheqë kuotimin e tij të çmimeve pas afatit për dorëzimin të kuotimeve të çmimeve dhe para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së kuotimit të çmimeve.

IV.6 KRITERET PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Kontrata do t'i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

Tenderin e përgjegjshëm, **me çmimin** ekonomikisht me të favorshëm.

NENI V ANKESAT

Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, ankesa mund të dorëzohet, pa pagesë, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Forma standarde e ankesës mund të shkarkohet nga faqet e internetit të KRPP-së ose OSHP-së: www.krpp.rks-gov.net ose www.oshp.rks-gov.net.

Ankesat duhet të dorëzohen në origjinal te Autoriteti Kontraktues, në adresën e specifikuar në Nenin I.1) të kësaj Dosjeje të Tenderit.

DOSJA E TENDERIT PËR Procedurën e Kuotimit të Çmimit

Kurdo qe ankesa ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.

Kurdo qe ankesa ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës që i është dërguar ankuesit.

Kurdo qe ankesa ka te beje me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Të gjitha ankuesit duhet të paguajnë një tarifë për ankese ne shumë prej (shëno shumën në €), së bashku me paraqitjen e një ankese ne OSHP. Paga do të bëhet në para të gatshme ose të holla ekuivalente në llogarinë e krijuara nga OSHP-ja.

Referojuni LPP dhe Rregullave të Prokurimit për procedurat e ankimeve të mëtejshme.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendos specifikime teknike qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet te ceke specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë janë.

3. Nëse objekti i kontratës është i ndarë në pjesë përshkruaj secilën pjesë në tabelën e më poshtëme

	Përditësimi i të dhënave për dy portale digjitale dhe ofrimi i dy zgjidhjeve të reja digjitale sipas projekteve që implementohen nga Open Data Kosovo (ODK)	Lloji i shërbimit	kohëzgjatja
1.	<u>Hulumtimi dhe Përditësimi i portalit të Bizneseve të Hapura si dhe shtimi i moduleve të reja (biznesetehapura.com)</u>	- shërbime softuerike dhe të dhënave	18 muaj

DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e Kuotimit të Çmimit

2.	<u>Zhvillimi i mëtutjeshëm i portalit Edu-permanca, shtimi i të dhënave dhe moduleve (edu-permanca.org)</u>	shërbime softuerike dhe të dhënave	18 muaj
3.	<u>Zhvillimi i zgjidhjeve digjitale, për digjitalizim të proceseve në dy institucione të përzgjedhura publike</u>	- shërbime softuerike dhe të dhënave	18 muaj

Informata shtesë për realizimin e projekteve:

1. Hulumtimi dhe Përditësimi i platformës së Bizneseve të Hapura dhe shtimi i moduleve te reja (biznesetehapura.com)

Nga kontraktori kërkohet që të bëhet përditësimi i të dhënave të platformës Bizneset e Hapura me informacione të reja biznesi dhe krijimi i rasteve të reja bazuar në gjetjet dhe hulumtimin e bërë. Ky aktivitet do të zhvillohet nga konsulent dhe inxhinier softuerik duke përditësuar të dhënat në portal nëpërmjet nxjerrjes së statistikave duke përdorur metodën ueb scrapping. Poashtu, kontraktori do ta ketë përgjegjësinë e mirëmbajtës së faqes gjatë kësaj kohe. Ofrimi i rekomandimeve dhe zhvillimi i moduleve të reja sipas nevojës. Kontraktori do të ofroj shërbime të konsulences sofuerike, përfshirë të paktën në gjuhët e mëposhtme programuese: JavaScript, Java, HTML, CSS, React, Angular. Ky projekt parashikohet të zhvillohet në dy faza, njëra gjatë vitit 2022 dhe tjetra gjatë 2023.

2. Zhvillimi i mëtutjeshëm i portalit Edu-permanca, shtimi i të dhënave dhe moduleve (edu-permanca.org)

Nga kontraktori kërkohet të bëhet shtimi dhe përditësimi i të dhënave për platformën eduperdormanca.org në mënyrë që të arrihet një kuptim më i thellë mbi perspektivën e nxënësve në mjedisin arsimor. Shtimi i të dhënave duhet të bëhet për komunitat tjera në Kosovë, të paktën për 10 komuna shtesë nga ato ekzistueset. Poashtu kontraktori do ta ketë përgjegjësinë e mirëmbajtjes së faqes gjatë kësaj kohe. Ofrimi i rekomandimeve dhe zhvillimi i moduleve të reja sipas nevojës. Kontraktori do të ofroj shërbime të konsulences sofuerike, përfshirë të paktën në gjuhët e mëposhtme programuese: JavaScript, Java, HTML, CSS, React, Angular. Ky projekt parashikohet të zhvillohet në dy faza, njëra gjatë vitit 2022 dhe tjetra gjatë 2023.

3. Zhvillimi i zgjidhjeve digjitale, për digjitalizim të proceseve në dy institucione të përzgjedhura publike

Kontraktori në bashkëpunim me ODK do të zhvilloj dy zgjidhje digjitale për dy institucione të përzgjedhura nga ODK me qëllim të digjitalizimit të proceseve të institucioneve publike. Këto zgjidhje duhet ti shërbejnë rritjes së transparencës dhe lehtësimit të punës së këtyre institucioneve publike. Zgjidhjet do të jenë të limituara në digjitalizim dhe webaplikacione të përshtatshme për qasje nga shërbyesit civil apo qytetarët. Kontraktori do të ofroj shërbime të konsulences sofuerike, përfshirë të paktën në gjuhët e mëposhtme programuese: JavaScript, Java, HTML, CSS, React, Angular. Ky projekt parashikohet të zhvillohet në dy faza, njëra gjatë vitit 2022 dhe tjetra gjatë 2023.

Aneksi 2.

DEKLARATA NËN BETIM

DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e Kuotimit të Çmimit

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin III.1 të Informacionit për Tenderuesit, dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
Përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

Aneksi 3.

KËRKESË PËR INFORMACIONE SHITESË

Për: **Open Data Kosovo**

DUKE MARRË PARASYSH SE [emri i operatorit ekonomik] (më tej "Operatori Ekonomik"), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e dosjes së tenderit:

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identikuara.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
Përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e Kuotimit të Çmimit

Aneks 4 - LISTA E KONTRATAVE TË REALIZUARA NË TRI VITET E SHKUARA NGA DATA E PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT PËR KONTRATË

Nr.	Titulli i Kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës dhe mbarimit të kontratës	Vlera e realizuar e kontratave	Emri i Autoritetit Kontraktues apo Blerësit	E-mail dhe nr.tel i Blerësit
1					
2					

(hiq ose shto sipas nevojës)

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri OE:	
Adresa e plotë:	
Emri e mbiemri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e Kuotimit të Çmimit

--	--

PJESA B: *Draft KONTRATA*

Open Data Kosovo, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një të anë; dhe

[shëno emrin e Operatorit Ekonomik] (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Përditësimi i të dhënave për dy platformave digjitale dhe ofrimi i dy zgjidhjeve të reja digjitale sipas projekteve që implementohen nga Open Data Kosovo (ODK)

me numër Identifikues: *02/2022-ODK*.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë përgatitja e: **Përditësimi i të dhënave për dy platforma digjitale dhe ofrimi i dy zgjidhjeve të reja digjitale sipas projekteve që implementohen nga Open Data Kosovo (ODK)**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me *datën e nënshkrimit* dhe përfundon me pranimin

1.3 **Afatet kohore** për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: më së largu **10 ditë kalendarike, pas nënshkrimit të kontratës**. Afati i dorëzimit të furnizimeve duhet të jetë jo më shumë se **10 ditë kalendarike**, nga marrja e *Fletë porosisë* nga Menaxheri i Kontratës.

1.4 **Vendi për kryerjen e shërbimeve** është: Open Data Kosovo.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

DOSJA E TENDERIT PËR Procedurën e Kuotimit të Çmimit

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë, me shifra: _____ €; dhe
me shkrim: _____.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [furnizimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të [furnizimeve]

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e Kuotimit të Çmimit

çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *[Shqip]* *[Serbisht]* *[Anglisht]* ¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Emri:

Emri:

Pozita:

Pozita:

Nënshkrimi:

Nënshkrimi:

Data:

Data:

Vula:

Vula:

PJESA C: **FORMULARI I PARAQITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT**

Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Për **OPEN DATA KOSOVO** (më tej "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i Kontratës: Përditësimi i të dhënave për dy portale digjitale dhe ofrimi i dy zgjidhjeve të reja digjitale sipas projekteve që implementohen nga Open Data Kosovo (ODK)

Në përgjigje të letrës suaj të ftesës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr. 02/2022 – ODK. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Çmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

Çmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: *[shëno çmimin e përgjithshëm në shifra €]*

Dhe me shkrim *[shëno çmimin e tenderit me shkrim Euro]*

3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej **30 ditë** nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

DOSJA E TENDERIT PËR Proceduren e Kuotimit të Çmimit

4. Ne jemi duke e bërë këtë aplikim, për këtë kuotim në të drejtën tonë të udhëhequr nga vetja. Ne konfirmojmë se ne nuk jemi duke tenderuar për kontratën e njëjtë në ndonjë formë tjetër.

[Në rast të një konsorciumi]

Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë kuotim **si partner në konsorcium**, të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Ne konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

5. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësisht të njohim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të financuara nga BKK.

6. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

DORËZUAR NGA:

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË ²	
ADRESA E PLOTE	
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	
POZITA	
NËNSHKRIMI	
DATA	
VULA	

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik:]

² Në rast të Grupit të OE emri i liderit të Grupit të OE

	Emri(at)	Adresa-banimi
Udhëheqësi 1*		
Etj ... *		

* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: **[shëno emrin dhe mbiemrin]**

Nënshkrimi: **[nënshkrimi i personit të autorizuar]**

Vendi dhe data: **[shëno vendin dhe datën]**

Vula e Udhëheqësit: _____

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	ÇMIMI NJËSI PA TVSH €	Çmimi total PA TVSH €
1.					
2.					
3.					
4.					
Totali i Përgjithshëm:					

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	
ADRESA E PLOTE	
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	
POZITA	
NËNSHKRIMI	
DATA	
VULA	